



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

NJOFTIM

Për fillimin e procedurave të vetkandidimit për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 37, 38, 40, 41, 42, të Statutit të Universitetit të Tiranës, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të vetkandidimit për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional**, konkretisht për:

- A. Komisioni i promovimit të personelit akademik,**
- B. Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët,**
- C. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë,**
- Ç. Komisioni i përhershëm i kurrikulës.**

A. Bazuar në nenin 38, pika 2 të Statutit të UT-së, **Komisioni i promovimit të personelit akademik**, përbëhet nga 7(shtatë) anëtarë, të cilët vetkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bazuar në pikën 4 të nenit 38 të Statutit të UT-së, Anëtarët e Komisionit të promovimit të personelit akademik, duhet të plotësojnë këto kritere:

1. të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;
2. të mbajë titullin “profesor” dhe të kenë së paku 5(pesë) vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli;
3. të kenë përvojë pune si anëtar të personelit akademik të paktën 10 vjet;
4. të mos jenë anëtarë të zgjedhur në organet drejtuese.

B. Bazuar në nenin 40, pika 1 të Statutit të UT-së, **Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët**, përbëhet nga 7(shtatë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë, pjesë e personelit akademik dhe 3 (tre) anëtarë, përfaqësues të studentëve, të cilët vetkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

C. Bazuar në nenin 41, pika 2 të Statutit të UT-së, **Komisioni i Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë**, përbëhet nga 11(njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen të paktën nga një përfaqësues nga secili fakultet i UT-së, 1(një) përfaqësues nga strukturat e sigurimit të cilësisë në Rektorat, 1(një) përfaqësues nga institutet/degët dhe 3(tre) përfaqësues të studentëve, të cilët vetkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bazuar në pikën 2 të nenit 41 të Statutit të UT-së, Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, **pjesë e personelit akademik**, duhet të plotësojnë këto kritere:

1. t'i përkasin kategorisë “*Profesor*”
2. të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku 5 vjeçare
3. të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

Bazuar në pikën 2 të nenit 41 të Statutit të UT-së, Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, **përfaqësues i studentëve**, duhet të jetë me notë mesatare të përgjithshme mbi 9.

Ç. Bazuar në nenin 42, pika 2 të Statutit të UT-së, **Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës**, përbëhet nga 13(trembëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen të paktën nga një përfaqësues nga secili fakultet i UT-së, 2(dy) përfaqësues nga strukturat ndihmësakadematike me karakter administrativ në aparatet e Rektoratit, 1(një) përfaqësues nga institutet si dhe 2(dy) përfaqësues të studentëve, të cilët vetkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bazuar në pikën 2 të nenit 41 të Statutit të UT-së, Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, **pjesë e personelit akademik**, duhet të plotësojnë këto kritere:

1. t'i përkasin kategorisë “*Profesor*”
2. të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku 5 vjeçare
3. të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

Bazuar në pikën 2 të nenit 41 të Statutit të UT-së, Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, **përfaqësues i studentëve**, duhet të jetë me notë mesatare të përgjithshme mbi 9.

Periodha e vetkandidimit të kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional, të sipërcituara, do të jetë nga **data 04-13 Mars 2019, pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UT-së, çdo ditë nga ora 8.00-14.00.**

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga kandidatët konkurrent është si më poshtë:

1. Kërkesë duke specifikuar komisionin për të cilin aplikon
2. CV
3. Kopje të titullit shkencor “*Profesor*”, “*Profesor i Asociuar*”.
4. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi.
5. Vërtetim që nuk ka marrë masë disiplinore.
6. Vërtetim që është student (*për kandidatët studentë*)
7. Listë notash (*për kandidatët studentë*)

Të merren masat nga ana juaj për njoftimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe studentët e fakultetit/institutit/filialit tuaj, duke bërë edhe shpalljen e këtij njoftimi në faqen tuaj *online*.